




REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME
Nr.01-060/01-4731/24 datë:16.02.2024



Npi – 01/77 datë: 26.02.2024

Bazuar në nenet 12.2 shkronja (d), si dhe neni 58 shkronja (h) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28/2008); Statutit të Komunës së Shtimes 01Nr.06/1636 të datës 03.09.2008; Si dhe në mbështetje të nenit 4 dhe nenin 10 pika 2 të Rregullores Komunale për Simbolet, Titujt e Nderit, Dekoratat, Medaljet, Mirënjohjet dhe Falënderimet, Npi – 01/173, të datës 27.5.2009; Të nxitur nga nevoja për ndarjen e çmimit "Qytetar Nderi" për personalitetet që kanë dhënë kontribut domethënës për Komunën e Shtimes, duke respektuar procedurat e akteve ligjore dhe nënligjore, Kuvendi i Komunës së Shtimes, në seancën e mbajtur më: 26.02.2024, miratoi këtë:

V E N D I M

**PËR ZGJEDHJEN E KOMISIONIT PËR NDARJEN E ÇMITIT
"QYTETAR NDERI"**

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes në Seancën e -II- të rregullt për vitin 2024, të mbajtur më: 26.02.2024, unanimisht formoi Komisionin për ndarjen e çmimit "Qytetar Nderi" në Komunën e Shtimes, në përbërje prej pesë (5) anëtarëve si vijon:

1. Ruzhdi Jashari – I emëruar nga Kryetari i Komunës (Kryetar i Komisionit)
2. Besnik Seferi – Përfaqësues i Kuvendit nga pozita, (Anëtar i Komisionit)
3. Reshat Mujota – Përfaqësues i Kuvendit i pavarur, (Anëtar i Komisionit)
4. Valon Januzi – I emëruar nga Kryetari i Komunës (Anëtar i Komisionit)
5. Fadil Hysaj – Përfaqësues nga Shoqëria Civile, (Anëtar i Komisionit)

II

Vendimi është aprovuar duke marrë për bazë edhe Rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa, Npi-01/68 datë: 23.02.2024, si dhe Rekomandimin e Komitetit për Komunitete Npi-01/70 datë: 23.02.2024.

III

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale, si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb - faqen e Komunës së Shtimes.

IV

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Drejtorive, Kryetarit të Komunës, Ministrisë të Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Zyrës për informim.



Kryesuesi i Kuvendit
Adnan Ademi